



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **24/2025**

Data: **24 mars, 2025. Ora: 11:00**

Vendi: **KQZ/ Prishtinë**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ nr.20/2025

3. Shqyrtimi i mandatit të U.D Drejtorit të SKQZ

4.Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kryesuesi i takimit, z. Kreshnik Radoniqi, paraqiti agjendën e takimit. Ai, paraqiti edhe dy pika: vëzhgimin e zgjedhjeve në Shqipëri, dhe një ftesë por na duhet gjuha frënge. Si dhe dy çështje për diskutim për DOZ, dhe ndaljen e fondit, si do ja bëjmë për muajin mars...

Agjenda, u miratua me 9 vota të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Pastaj, u miratua procesverbali nr. 20/2025 me 8 vota, dhe 1 votë abstenim.

2. Shqyrtimi i mandatit të U.D Drejtorit të SKQZ:

Kreshnik Radoniqi: Sot, i skadon mandati gjashtëmuorë drejtorit të Sekretariatit, sipas ligjit mundemi me vazhdue edhe për gjashtë muaj... Më tej, nuk mundemi. Propozimi im, është t'i vazhdohet por që brenda këtyre gjashtë muajve të përgatitet konkursi, dhe të mos vijmë në pozitë të mbesim pa drejtor...

Ilir Gashi: Unë, nuk jam që të vazhdohet mandati për asnjë ditë pa u shpall konkursi. Na është bërë mollë sherri një nen, i cili është bërë problem që e kërkon si specifike "njohjen e gjuhës angleze"...Unë, propozoj që të riformulohet ky nen, ose të hiqet fare. Në anën tjetër, nuk jam që të vazhdohet mandati për gjashtë muaj, por për tre muaj sepse ne hyjmë në zgjedhje lokale dhe duhet ta kemi kryeshefin e zgjedhur...

Kreshnik Radoniqi: Për çështjen e nenit, pajtohem edhe unë. Sa për konkurs, këtë e bënë Zyra e Personelit dhe ne nuk duhet të marrim vendim...

Alban Krasniqi: Nuk mendoj se neni është problem, por arsyeja është se njerëzit nuk vijnë me konkurre sepse, është një institucion problematikë, sfidues dhe ju tregoj se ka institucione ku për udhëheqës të divizioneve jo të drejtorive, e kanë kusht kryerjen e "B-2" it. Tash, me ardh një drejtues e ne duhet me sigurua përkthyes për gjuhën angleze, ne vetëm shkojmë teposhtë...

Jam kundër kësaj çështje, kur kriteret janë minimale. Aspektet e punës tonë i kemi edhe me ndërkombëtarët, bashkëpunimin etj. Nëse dikush në menaxhime të larta nuk e njeh gjuhën angleze, kjo nuk ka sens...

Gordana Llaban: Kemi mundur me e shpall dy herë deri tash konkursin, paralelisht...!

Kreshnik Radoniqi: Unë, po mendoj që si kriter të mos jetë, por të jetë si e dëshirueshme njohja e gjuhës së huaj. Është diçka që mundet me u largue, e mandej e lehtësojmë interesimin e atyre që duan të konkurojnë në konkurs...

Sami Hamiti: Konkursi, duhet të shpallet më herë, mos me pritë procesin. Realisht, mos me e lënë anash. Njohja e gjuhës të jetë e preferueshme, por mos me u kufizue me një letër formale...

Kreshnik Radoniqi: Me qenë e preferueshme, por jo e detyrueshme..

Arianit Elshani: Pajtohem me vazhdimin e mandatit, por paralelisht të hapet edhe konkursi. Në rregullore, i kemi dy filtra dhe kandidati, sanksionohet që ta njoh gjuhën angleze... Jam i bindur që nga brenda nuk kemi mjaftueshëm menaxherë që me e udhëheqë sekretariatit: po, edhe piari duhet me qenë...

Mufera Shinik: Jam për hapjen e konkursit, por mos me qenë kriter gjuha angleze. Për mue, nuk duhet me qenë kusht gjuha...

Si në vijim, diskutuan: Alban Krasniqi, Kreshnik Radoniqi, Ilir Gashi, Sami Kurteshi...

Ilir Gashi: Kam dy propozime, një që të vazhdohet mandati për 3 muaj me kriteret aktuale, pra mos me hy në zonën ku rrezikohemi. Dy, nëse shkojmë me 6 muaj, unë nuk pajtohem...

Kreshnik Radoniqi: Ne, e vazhdojmë sipas ligjit për 6 muaj, por deri në zgjedhjen e drejtorit, por jo më gjatë se 6 muaj. Kështu thotë ligji...

Kreshnik Radoniqi: E hedh në votim për 6 muaj vazhdimin e mandatit. Ndërsa, sot do të merrem me çështjen e shpalljes së konkursit. Kush është për vazhdimin e mandatit...?

Me 9 vota për, vazhdohet për gjashtë muaj mandati i U.D Drejtorit të SKQZ

Kreshnik Radoniqi: Edhe dy – tri çështje: një, vëzhgimi i zgjedhjeve në Shqipëri që janë më 11 maj, 2025. KQZ e Shqipërisë, i paguan shpenzimet për tre persona. Ne, merremi vendim më vonë kush shkon...! A marrim vendim, kush është për...?

Me 8 vota për, miratojet pjesëmarrja...

Kreshnik Radoniqi: Çështja e dytë, e kemi një ftesë për një konferencë në Mauritani, një konferencë por atje flitet frëngjishtja. Nuk mundemi me marrë pjesë, pra ne i njoftojmë ata...

Çështja e tretë: Rekomandimi për fondin, a e bëjmë si në mars...? Por, duhet me marrë vendim, dhe ka ndalesa, siç më ka informue Besniku. A, me marrë vendim unë prapë, a po pajtoheni...? Një vendim për mars, e mandej për tjerat merrem vesh me Besnikun si ja bëjmë...

Çështja e katërt: një kompani e huaj ka interesim për një prezentim lidhur me identifikimin elektronikë...!

Nëse mendoni, mundemi mi thirr, na e bëjnë një prezantim dy – tri orë...

Mirë, ok. U them ta planifikojnë dhe të vijnë ta bëjnë prezantimin...

3. Të ndryshme !